

Tema IV: Procesi i kontrollit parlamentar

Leksioni 8: Kontrolli parlamentar në komisione

Leksioni 9: Kontrolli parlamentar në seancë plenare

Leksioni 8: Kontrolli parlamentar në komisione

- a) Funkzioni i kontrollit parlamentar**
 - b) Raportimi i qeverisë në komisionet parlamentare**
 - c) Kontrolli i zbatimit të buxhetit të shtetit**
 - d) Seancat dëgjimore**
 - e) Raportet e kontrollit të komisioneve**
 - f) Komisionet hetimore**
-

a) Funkzioni i kontrollit parlamentar

Funksioni i kontrollit parlamentar është atribut kushtetues i institucionit të Parlamentit. Funksioni i kontrollit përcakton veprimtarinë politike të Parlamentit dhe përfshin një numër të madh instrumentesh, nga ato që vënë në pikëpyetje përgjegjësinë e qeverisë deri në ato të veprimtarisë me karakter thjesht informativ.

Funksionet kryesore të kontrollit parlamentar janë:

- Të zbulojë dhe të parandalojë abuzimet, sjelljet arbitrare ose jo ligjore dhe antikushtetuese të qeverisë dhe të organizmave publikë. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të qytetarëve është në qendër të këtij funksioni.
- T'i kërkojë qeverisë llogari për mënyrën sesi ajo përdor fondet publike, me qëllim përmirësimin e efikasitetit të shpenzimeve publike dhe mos lejimin e abuzimeve financiare në veprimtarinë e administratës.
- Të mbikëqyrë zbatimin me efektivitet të politikave të programuara nga qeveria.
- Të bëjë transparencën e veprimtarisë së qeverisë dhe të forcojë besimin e qytetarëve kundrejt shtetit ligjor

Janë dispozitat kushtetuese ato që zakonisht përcaktojnë mjetet që duhet të përdorin parlamentet për ushtrimin e funksionit të kontrollit: pyetjet, interpelancat, mocionet, debatet, hetimet, informacioni, raportimi, etj. Mënyrat se si këto mjete përdoren, ndryshojnë nga një parlament në tjetrin; ato ushtrohen sipas procedurave të caktuara në rregulloret e Parlamentit. Karakteristikë e përbashkët e tyre është se funksioni i kontrollit parlamentar ushtrohet si nga komisionet parlamentare, ashtu edhe nga parlamenti në seancë plenare.

Në përgjithësi qeveritë parlamentare përpiqen të kufizojnë aftësinë e parlamentit për nxitjen e kontrollit parlamentar. Një ekspert britanik¹

¹ Partitë në Parlament, seria e hulumtimeve legjislative, botim USAID, 2005, f.56

përcakton tri motive të qeverisë për frenimin e përpjekjeve parlamentare për mbikëqyrje. “Së pari, qeveritë thjesht e shohin më të lehtë në atë mënyrë.... Qeveritë nuk duan të dalin zbuluar para mbikëqyrjes më të gjerë dhe ndoshta më të efektshme, gjë që do t’ua bënte jetën më të vështirë....Së dyti, qeveritë nuk dëshirojnë ta ndajnë pushtetin më tej, vetëm nëse kjo është e domosdoshme...Së treti, dhe kjo rrjedh nga e dyta, partitë në pushtet (dhe ato që aspirojnë për pushtet) nuk dëshirojnë të shohin zvogëlimin e mundësisë për të zbatuar politikat e tyre.” Ulja e vazhdueshme e efektivitetit të ushtrimit të kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit konsiderohet si përbërësi kryesor i asaj që quhet “*kriza e institucionit të Parlamentit*”.

Komisionet parlamentare janë një instancë që lehtëson kontrollin e detajuar të projektligjeve, kontrollin e veprimtarisë ndaj qeverisë dhe ndërveprimin me publikun e me aktorët e tjerë të jashtëm. Komisionet u ofrojnë deputetëve mundësi të fuqishme kontrolli. Një pjesë e rëndësishme e veprimtarive parlamentare sot zhvillohet më shumë në komisione sesa në seancë plenare. Këtu duhet të bëjmë një dallim të rëndësishëm midis komisioneve të përhershme dhe komisioneve *ad hoc*, të krijuara për të trajtuar një çështje konkrete në një afat të dhënë.

Parlamentet në përgjithësi kanë një sërë komisionesh të përhershme, që përfshijnë fusha të kompetencës së ministrive (komisione sektoriale). Këto komisione mund të organizohen në mënyrë që të reflektojnë saktësisht ministritë. Ato mundet gjithashtu të kontrollojnë më shumë se një ministri, dhe një ministri mund të jetë e kontrolluar prej dy ose më shumë komisione parlamentare. Zakonisht komisionet e përhershme janë të ngarkuar njëkohësisht të shqyrtojnë edhe nismat ligjore edhe të kontrollojnë ministrinë korresponduese.

Parlamenti mundet gjithashtu të vendosë një komision të përgjithshëm të kontrollit, që koordinon veprimtaritë e kontrollit të komisioneve të tjera të përhershme. Një komision i përgjithshëm i kontrollit mund të rekomandojë që komisionet e tjera të përhershme të hetojnë mbi disa probleme konkrete që ai i ka identifikuar. Komisionet e përhershme mundet gjithashtu të sjellin çështjet para komisionit të përgjithshëm të kontrollit. Komisionet mund të funksionojnë si instanca të ndërmjetme midis grupeve të interesit e autoriteteve kompetente dhe mund të jenë një portë hyrjeje për qytetarët që dëshirojnë ta marrin pjesë në punët parlamentare.

Dihet tashmë që përbërja e një komisioni reflekton përbërjen e Parlamentit. Grupet politike përgjithësisht përfaqësohen në komisione në përputhje me peshën e tyre numerike në Parlament. Një vëmëndje e veçantë duhet të tregohet për grupet e vogla, në mënyrë që ato të jenë të përfaqësuara në komisione si anëtare ose si vëzhguese. Në pamje të parë krijohet përshtypja se funksioni i kontrollit është atribut ekskluziv vetëm i opozitës. Mospërfshirja reale e grupeve të shumicës në ushtrimin e funksionit të kontrollit zbeh së tepërmi atributin kushtetues të kontrollit nga ana e Parlamentit. Vetëm prania e anëtarëve të opozitës në komisione nuk mjafton për të garantuar një kontroll parlamentar efektiv.

Shumë faktorë të tjerë influencojnë mbi mënyrën se si komisionet ushtrojnë rolin e tyre të kontrollit. Së pari, kur një grup parlamentar dominon një shumicë parlamentare, i njëjti grup mund të përbëjë shumicën në çdo komision. Aktivitetet e kontrollit të komisioneve kërkojnë bashkëpunimin e grupit parlamentar të partisë kryesore të shumicës. Partia e shumicës qeverisëse normalisht është e prirur të kërkojë mundësinë e kufizimit të

punëve të kontrollit. Së dyti, vendet kyçe të komisioneve mund të jenë monopolizuar nga partitë e qeverisë, nëse këto poste vendosen nga shumica e parlamentit. Mënyra se si komisionet drejtohen është e rëndësishme, sepse kryetarët e komisioneve janë përgjithësisht të ngarkuar të përpunojnë projektprogramin e punës. Në parlamentet ku koalicionet janë shumëpartiake, postet drejtuese janë shpërndarë midis partive të ndryshme. Në disa parlamente rregullat parashikojnë që partitë e opozitës të marrin disa poste në komisione dhe/ose në organin kolegjal të drejtimit të komisionit (shpesh quhet kryesi ose byro).

Një tjetër faktor i rëndësishëm që ndikon në efektivitetin e procesit të kontrollit është mënyra se si zhvillohen seancat e mbledhjeve të komisioneve: me dyer të mbyllura ose të hapura për publikun.

Seancat me dyer të mbyllura kanë mundësinë të ndikojnë në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet partive, sepse minimizojnë vënien e qeverisë në pozitë të vështirë. Seancat e zhvilluara jashtë syrit të publikut, pra që zhvillohen jo nën efektin e konkurrencës partiake, mund të ndikojnë në sjelljen e ndryshimeve të rëndësishme në vendimmarrjen politike. Megjithatë, seancat e mbyllura ulin transparencën dhe përjashtojnë median e publikun nga mundësia e angazhimit në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave.

b) Raportimi i qeverisë në komisionet parlamentare

Komisionet parlamentare mundet të shqyrtojnë raporte të paraqitura nga qeveria, si dhe mundet gjithashtu të kërkojnë që ministrat përgjegjës të shpjegojnë raportet e tyre e të japin informacione plotësuese për çështjet e trajtuara. Komisionet parlamentare mund të kërkojnë praninë e anëtarëve të qeverisë dhe kjo është një prej kushteve kryesore të efikasitetit të rolit të tyre të kontrollit. Nëse një anëtar komisioni vlerëson që prania e një ministri është e nevojshme, ai ia shpreh këtë mendim kryetarit të komisionit, i cili ia transmeton kërkesën ministrit përkatës. Ministri i kërkuar paraqitet si person ose delegon një përfaqësues të tij; ai duhet të ketë një arsye të vlefshme për të refuzuar. Duke marrë sqarime më të detajuara prej ministrave, komisionet janë më në gjendje të vlerësojnë veprimtarinë e qeverisë. Diskutimet e ndërsjellta në sallat e komisioneve u lejon parlamentarëve t'u kërkojnë llogari anëtarëve të qeverisë për aktivitetet e ministrive të tyre. Takimet e një komisioni me ministrat përkatës mund të zhvillohen gjithashtu në kuadër informal. Në Vendet e Ulëta², për shembull, takime të tilla quhen "konsultime". Siç duket nga emri, në këto mbledhje përgjithësisht nuk ka dhënie llogarie. Në Danimarkë³ këto konsultime mund të regjistrohen me kërkesën e të paktën tre anëtarëve të komisionit. Në disa parlamente komisionet paraqesin kërkesa informale të paraqitjes së funksionarëve të ministrisë përgjegjëse.

Në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë⁴, përcaktohet se "komisionet kanë të drejtë të thërrasin në çdo kohë ministrat për të dhënë shpjegime dhe sqarime për probleme të fushave ku ata janë individualisht përgjegjës, si dhe për zbatimin e ligjeve, të vendimeve, rezolutave ose deklaratave të miratuara nga Kuvendi. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve, japin shpjegime dhe informojnë për çështje që lidhen me

² Chambre des representants des Pays-Bas, Reglement, art.27, 28

³ Parlement danois, Reglement, art. 8

⁴ Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, neni 102, pika 2,

veprimtarinë e tyre". Ndërsa në statutin e Parlamentit lituanëz përcaktohet se një prej kompetencave kryesore të komisioneve është "të shqyrtojnë programin e qeverisë, me inicitivën e tyre ose me udhëzim të Seimas, të shqyrtojnë programet e veprimtarisë së qeverisë ose të institucioneve të tjera publike, secili në fushën e vet specifike, dhe e gjithë kjo i nënshtrohet konkluzioneve të Seimas".

Kontrulli parlamentar realizohet ndaj administratës, e cila jep llogari, raportin dhe përgjigjet për veprimtarinë e saj. Nëpërmjet këtij kontrulli, parlamentarët kanë të drejtën të informohen për çështjet e administrimit të pushtetit dhe të zbatimit të ligjeve apo për çështje të caktuara, marrja dijani për të cilat konsiderohet e nevojshme për realizimin e qëllimeve dhe e detyrave të tyre, por gjithmonë brenda kuadrit të funksionit kushtetues. Në një shoqëri demokratike kjo mundësi që u jepet parlamentarëve rrjedh nga e drejta e popullit për të njohur dhe për të ditur se çfarë bëhet në emrin e tij. Prandaj kontrulli parlamentar ushtrohet edhe në kontekstin e të drejtës kushtetuese të çdo shtetasi për të marrë informacionin e nevojshëm për çështjet me interes publik. Organet e pushtetit publik, që i nënshtrohen kontrullit parlamentar, duke u transmetuar fakte e të dhëna përfaqësuesve të popullit, përmbushin njëkohësisht detyrimin kushtetues për të qenë transparentë në raport me publikun.

Komisionet e përhershme të ngarkuara me një fushë ministeriale kontrollojnë administratën e ministritë me iniciativën e saj ose me kërkesë të Parlamentit. Në disa parlamente, ministritë duhet t'i paraqesin komisionit përgjegjës një raport të aktivitetit të tyre për një periudhë kohe të caktuar. Në dhomën e deputetëve të Rumanisë⁵, për shembull, rregullorja precizon që "një herë në sesion, ministrat paraqesin një raport të punës dhe strategjitë e ministrive të tyre para komisionit përgjegjës. Kur qeveria paraqet politikat e saj në komisione, anëtarët e tyre mund të bëjnë pyetje".

Janë drejtuesit e komisioneve që përpunojnë programin e tyre të punës, gjë që u jep atyre një marzh manovrimi të konsiderueshëm për të inkurajuar ose penguar aktivitetin e tyre të kontrullit. Ekzistojnë dy mënyra drejtimi në komisione: në disa parlamente, kryetari i komisionit është i vetmi person që merr vendimet, ndërsa në disa të tjera, komisionet kanë një organ kolegjal drejtimi, kryesinë. Partitë në pushtet dhe ato të opozitës përgjithësisht ndajnë vendet në kryesinë e komisioneve.

Në parlamentet ku komisionet e përhershme bëjnë shqyrtimet e projektligjeve dhe janë të ngarkuara gjithashtu të kontrollojnë ministritë përkatëse, është e rëndësishme të rezervohet kohë e mjaftueshme për aktivitetet e kontrullit. Për shembull, në dhomën e përfaqësuesve belgë⁶, në fillim të çdo sesioni vjetor, komisionet e përhershme vendosin një kalendar javor që përcakton në parim kohën e rezervuar për punën legjislative dhe kohën e rezervuar për punën e kontrullit (thirrje për të raportuar raport, shqyrtim raporti, kontrolle të ndryshme etj). Kalendari i komunikohet Konferencës së Kryetarëve. Komisionet parlamentare zhvendosen shpesh në institucionet publike dhe në vendet e tjera për të shqyrtuar detajet e programeve administrative specifike dhe zbatimin e tyre.

Si një instancë legjislative, parlamenti vlerëson zbatimin e ligjeve që ai ka votuar. Ky vlerësim kryhet përgjithësisht kur parlamentarët shqyrtojnë projektligjet, por gjithashtu ai mund të kryhet indirekt edhe nëpërmjet aktiviteteve jolegjislative të komisioneve. Në Parlamentin sllovak komisionet

⁵ Chambre des deputes de Roumanie, Reglement, art. 54

⁶ Chambre des representants de la Belgique, Reglement, art.35

kontrollojnë sidomos respektimin e zbatimit të ligjeve dhe verifikojnë nëse aktet e nxjerra në zbatim të tyre janë në përputhje me ligjin. Kur komisioni konstaton një mungesë kundrejt ligjit ose kur akti i nxjerrë është në kundërshtim me ligjin, si dhe kur akti nuk është nxjerrë, ai duhet të njoftojë qeverinë dhe kërkon marrjen e menjëhershme të masave për korrigjimet e nevojshme. Nëse asnjë masë nuk merret, komisioni i bën një raport Këshillit Nacional. Në komisionet e përhershme të Asamblesë Nationale franceze caktohen një ose disa anëtarë të komisioneve për të studiuar zbatimin e ligjit. Parlamentet mund të përfshijnë dispozita në ligje për të detyruar qeverinë të raportojë periodikisht për zbatimin e tyre. Këto raporte i nënshtrohen direkt shqyrtimit prej komisioneve përgjegjëse.

Kontrolli i zbatimit të ligjeve mundet gjithashtu t'i besohet një komisioni të kontrollit të specializuar. Misioni i një komisioni të tillë është të verifikojë zbatimin e ligjit, efikasitetin e ligjeve të miratuara dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tyre. Nëse është e nevojshme, ky komision mund propozojë plane veprimi të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, çdo komision parlamentar mund të krijojë një nënkomision që bashkëpunon me komisionin e kontrollit. Nënkomisionet mund të studiojnë dhe vlerësojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin dhe efikasitetin e ligjeve, përfshirë edhe aktet e nxjerra në funksion të tyre. Gjithashtu, për të përcaktuar nëse këto ligje janë zbatuar në përputhje me ligjin, ai mund të shohë organizimin dhe funksionimin e organizmave dhe njësive të administratës së tyre, dhe, nëse është e nevojshme, të propozojnë ligje të reja apo amendamente për plotësimin e tyre. Çdo nënkomision kontrolli një kopje të raporteve të tij ia paraqet komisioneve të përhershme përkatës.

c) Kontrolli i zbatimit të buxhetit të shtetit

Kontrolli buxhetor është një funksion kryesor i komisioneve të përhershme sektoriale, sepse shumica e programeve qeveritare zbatohen mbi bazën e një buxheti të dhënë. Ligji i buxhetit bashkë me dokumentet anekse të tij, i miratuar nga parlamenti, caktojnë vlerat e alokuara për secilin prej objektivave politike që duhet të arrihen nga programet qeveritare.

Kontrolli buxhetor është instrumenti kryesor që i lejon komisionet të vlerësojnë programet qeveritare. Ndërsa kontrolli prej komisioneve ushtrohet kryesisht mbi ligjin e buxhetit dhe të llogarive publike, hetimet mund të shkojnë derisa të vihet në dyshim drejtësia apo fizibiliteti i një politike të ndërmarrë nga qeveria.

Disa parlamente⁷ disponojnë një komision parlamentar, që shërben për të kontrolluar imtësisht ekzekutimin e buxhetit nga ministritë. Në shumicën e rasteve është fjala për një komision të përhershëm. Në disa parlamente të tjera ky komision është një komision i posaçëm i krijuar çdo vit, i cili përfundon punën pasi ka kryer punët e tij me buxhetin vjetor.

Dalohen dy kategori kryesore komisionesh të përhershme të këtij tipi: njëri është Komisioni i Buxhetit ose i Financave, që i korrespondon Ministrisë së Financave. Ky komision bën të vlefshëm projektligjin e financave dhe kalon në sitë raportet e shpenzimeve publike në zbatim të buxhetit. Tjetri është Komisioni i Llogarive Publike, i cili nuk merr pjesë në shqyrtimin e projektligjit të buxhetit. Komisioni i Llogarive Publike është shpesh i ndryshëm në përbërjen e tij prej komisioneve të tjera të përhershme. Ai është shpesh i drejtuar prej një anëtarë të opozitës. Komisioni i Llogarive Publike

⁷ Les outils du controle parlementaire, Publie par l'UIP, 2007, f. 19

shqyrton zakonisht raportet e organit të lartë kombëtar të verifikimit të llogarive (në Shqipëri, Kontrolli i Lartë i Shtetit). Në disa vende, komisionet e përhershme sektoriale, që i korrespondojnë një apo disa ministrive, mundet gjithashtu të shqyrtojnë raportet e organit të lartë të verifikimit të llogarive: në Gjermani dhe në Austri, një nënkomision i përhershëm i Komisionit Buxhetor shqyrton llogaritë publike. Komisioni ngarkon disa anëtarë të tij të kontrollojnë disa ministri konkrete ose disa aspekte të administrimit. Në punën për përpunimin e raporteve të tij, Komisioni i kontrollit të zbatimit të buxhetit mund të privilegjojë raportet vjetore dhe ato të posaçme të organit të lartë të verifikimit të llogarive, ose të përdorë raportin e këtij institucioni si një mjet referimi për të hartuar raportin e vet ose rezolutën e parlamentit mbi llogaritë publike.

Komisioni mund t'ua drejtojë raportet e veta drejtpërsëdrejti autoriteteve qeveritare të interesuara, duke u kërkuar shpjegime dhe duke bërë rekomandime, të cilat qeveria duhet t'i ndjekë. Ai mundet gjithashtu t'i kërkojë organit të verifikimit të llogarive të bëjë kontrollin e disa programeve specifike, ose të disa aspekteve të këtyre programeve.

Përveç shqyrtimit të raporteve zyrtare prej komisioneve të specializuara, anëtarët e organit të verifikimit të llogarive mund të kenë akses në tërësinë e komisioneve parlamentare. Në Parlamentin polonez, një përfaqësues i autorizuar i Dhomës së Lartë të Kontrollit, duke marrë pjesë në seancën e një komisioni, mund të bëjë observime për raportet dhe informacionet që shqyrtohen në komision prej përfaqësuesve të qeverisë, ose prej personave të tjerë që marrin pjesë në seancë, dhe me kërkesën e komisionit, të shpjegojnë hetimet e kryera nga Dhoma e Lartë e Kontrollit.

Komisioni mundet gjithashtu t'i kërkojë qeverisë të japë informacione përmes një pyetësori. Relatorët specialë të Komisionit të Financave dhe të Ekonomisë në Asamblenë Nacionale franceze përdorin formularë për të marrë informacione nga ana e ministrive. Komisioni i Financave u kërkon 42 relatorëve specialë (një relator për çdo mision), që ai ka caktuar, të përgatisin raportet për anëtarët e komisionit mbi modulet buxhetore ("misionet") që ata kontrollojnë. Duke hartuar raportet e tyre, relatorët specialë bazohen mbi pyetësorët e plotësuar prej ministrive, si dhe mbi aktivitetet e tyre të kontrollit të kryer gjatë vitit. Relatorët e komisioneve mund të bëhen kanale të komunikimit me komisionet e tjera. Në Asamblenë Nacionale franceze, informacionet e marra prej relatorëve specialë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave u jepen relatorëve të emëruar prej komisioneve të tjera të përhershme. Komisionet e ngarkuara me kontrollin e zbatimit të buxhetit mundet gjithashtu t'u kërkojnë komisioneve të tjera të përhershme të bëjnë hetime mbi zbatimin e programeve specifike. Projektet afatgjata të qeverisë mundet të studiohen gjatë kontrollit vjetor të programeve qeveritare.

d) Seancat dëgjimore

K Kontrolli i programeve të administratës konsiston sidomos në vlerësimin e efikasitetit të dhënies së shërbimeve për qytetarët. Kur ky efikasitet varet prej sjelljes së qytetarëve kundrejt programeve, prej aktiviteteve të sensibilizimit të publikut, komisionet mund të kontribuojnë në forcimin e ndërgjegjes së publikut dhe në zbatimin më të mirë të politikave.

Ndërsa deklaratat e ministrive dhe raportet periodike përbëjnë një informacion kryesor, komisionet parlamentare kanë shpesh nevojë të marrin informacione të drejtpërdrejta prej atyre që marrin pjesë në zbatimin e

programeve specifike dhe/ose janë direkt përgjegjës për dhënien e shërbimeve. Gjithashtu, për të vlerësuar aktivitetet e qeverisë në një vështrim më të gjerë, komisionet mund të ftojnë ekspertë të jashtëm, të cilët sjellin sqarimet dhe analizat e tyre. Ato mund të dëshirojnë të zgjerojnë opinionin prej grupeve ose personave që përfitojnë prej këtij ose atij programi, ose që janë të penalizuar prej tyre. Përfshirja e qytetarëve në procedurat parlamentare, si, për shembull, në seancat dëgjimore, mund t'i ndihmojë komisionet parlamentare për të marrë informacione të vlefshme. Hapja e seancave dëgjimore ndaj publikut është një rast i mirë për komisionet parlamentare për të informuar qytetarët për aktivitetet e tyre.

Seancat dëgjimore mund të përdoren si një formë konsultimi ose si një mjet për të marrë dëshmi. Në këtë rast të fundit, informacionet e marra me shkrim dhe me gojë përfshihen në procesverbalin e mbledhjes së komisionit. Në disa parlamente, kur duan të marrin dëshmi, komisionet e përhershme mund të marrin vendim për mbajtjen e seancave dëgjimore të hapura ose të mbyllura. Në disa parlamente të tjera, komisionet duhet të marrin autorizim për të bërë seanca të hapura për publikun, ndërsa në disa parlamente të tjera komisionet e përhershme nuk mund të marrin dëshmi, pasi kjo është vetëm në kompetencën e komisioneve hetimore.

Një komision merr përgjithësisht vendimin për mbajtjen e një seance dëgjimore me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij. Në shumicën e rasteve komisionet nuk marrin miratimin e parlamentit ose të instancave qeverisëse për të mbajtur seanca dëgjimore. Kryetari i parlamentit mund të ketë një rol për autorizimin e seancave dëgjimore. Në disa parlamente, si ai i Spanjës, ftesat për të asistuar në seancat dëgjimore janë formalisht "noteruar" nëpërmjet kryetarit të Parlamentit; në disa parlamente të tjera, si në Belgjikë, komisionet duhet të njoftojnë kryesinë për mbajtjen e seancave dëgjimore; në Luksemburg, komisionet duhet të marrin autorizimin e kryetarit të Parlamentit dhe të Konferencës së Kryetarëve.

Në seancat dëgjimore është e rëndësishme të përcaktohet paraprakisht lista e personave që do të ftohen. Ata mund të jenë funksionarë, ekspertë, përfaqësues të grupeve të interesit apo shoqatave dhe deri te publiku. Funksionarët mund t'u japin komisioneve informacione të drejtpërdrejta për çdo program administrativ, detaje të lidhura me drejtimit kryesorë të politikës dhe shifra agregate të marra prej raporteve të ministrive dhe të qeverisë. Funksionarët mundet të paraqiten edhe si ndihmës të ministrave. Komisionet mundet të zbatojnë procedurat e dëgjimit për të ftuarit. Zakonisht zbatohen procedura të ndryshme për dëgjimin e funksionarëve dhe të personave që nuk janë pjesë e qeverisë.

Megjithëse funksionarët janë kompetentë në një fushë specifike të administratës, komisionet mund të kërkojnë mendimin e ekspertëve jashtë qeverisë për të marrë një pikëpamje alternative për çështjet në shqyrtim. Komisionet mund të ftojnë personalisht disa ekspertë të zgjedhur me kujdes ose të ftojnë ekspertë të rrjeteve politike për t'u shprehur. Ekspertët mund të dëgjohen njësoj si në rastin e konsultimeve, pa qenë nevoja e regjistrimit të fjalës së tyre.

Kur komisionet duan të vlerësojnë efikasitetin e programeve qeveritare, ato gjykojnë shpesh si të dobishme seancën dëgjimore me grupet e interesit që përfitojnë prej këtyre programeve specifike ose që janë të penalizuara prej tyre. Grupet e interesuara mundet të kërkojnë prej komisioneve që t'u jepet mundësia për të shprehur mendimin e tyre. Në vend që komisionet të ftojnë shumë grupe, duhet të përcaktojnë më parë cilat janë grupet e interesuara për

çështjen në shqyrtim dhe cilat janë instancat e tyre, në mënyrë që ftesat t'u drejtohen pikërisht atyre. Sindikatat dhe shoqatat janë shembulli tipik i këtyre kontakteve.

Komisionet kanë përgjithësisht kompetencën për të vendosur nëse seanca dëgjimore duhet të jetë e hapur për publikun. Ato mund të jenë të hapura për publikun në mënyra të ndryshme: mundet të autorizohet përjashtimisht që publiku të jetë në sallën e komisioneve ose mundet të ftohen persona të publikut të shprehur për çështjen. Në këtë rast, komisioni rezervon të drejtën të vendosë cilët janë personat që do të dëgjojnë pas propozimeve të marra. Në disa parlamente mbledhjet e komisioneve mbahen përgjithësisht të mbyllura, por komisionet mund të vendosin të mbajnë mbledhjet të hapura për shqyrtimin e publikut. Publiku mundet të ndjekë debatet në dy mënyra: ritransmetim nëpërmjet mediave, ose kanali parlamentar u lejon qytetarëve të ndjekin atë ç'ka ndodh në komisione, ose komisionet mundet të autorizojnë qytetarët të asistojnë direkt në mbledhje.

Në Parlamentin danez⁸ mbledhjet e zakonshme të komisioneve mbahen me dyer të mbyllura me përjashtim të rasteve kur komisioni vendos ndryshe. Rregullorja parashikon mundësinë që komisionet të zgjedhin forma të tjera të mbledhjeve:

- Mbledhjet publike: komisioni shqyrton një çështje ose më shumë. Komisioni mund të vendosë kush do të jetë i autorizuar të marrë pjesë në debat.

- Mbledhje publike me temë: anëtarët e komisionit dhe ministri shqyrtojnë fushat kryesore të mandatit të komisionit. Komisioni vendos formën që do të marrë mbledhja dhe hyrja e publikut në mbledhje.

- Seanca dëgjimore: komisioni vendos formën që do të marrë mbledhja dhe nëse publiku do të ketë akses atje.

Grupet e interesit dhe qytetarët mundet që opinionet e tyre t'i paraqesin me shkrim. Në Dhomën e deputetëve të Rumanisë "përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe ekspertët mund të paraqesin opinionet e tyre për çështjet e shqyrtuara në Dhomë ose të vënë në dispozicion të kryetarit të komisionit dokumente në lidhje me çështjen". Rregullat përcaktojnë nëse këto komunikime duhet të jenë publike. Këto opinione mundet të pasqyrohen në raportin e komisionit.

Për të siguruar sa më shumë informacione nga qytetarët, komisionet parlamentare kanë në dispozicion të tyre mjete të ndryshme për sensibilizimin e publikut, në mënyrë që ai të bëhet më i ndërgjegjshëm dhe të kuptojë më mirë sfidat e reja. Kështu, komisionet mund të organizojnë mbledhje me qytetarët, grupet e shoqërisë civile, organizatat sektoriale, dhe përfaqësues të administratës për të lehtësuar shkëmbimin e pikëpamjeve për aktivitetet e organizmave publike e të administratës dhe për të verifikuar efektet e tyre mbi shoqatat e grupet e interesit.

Parlamenti mund të mbrojë të drejtat dhe interesat e qytetarëve në rastet individuale. Aktivitetet e kontrollit të komisioneve përfshijnë marrjen në përgjegjësi të ankesave individuale të qytetarëve të depozituara kundër ministrisë përkatëse. Një numër parlamentesh zbatojnë një sistem që lejon racionalizimin e trajtimit të këtyre ankesave. Disa parlamente disponojnë një komision të ngarkuar shprehimisht me peticionet. Në Gjermani, Komisioni i Shqyrtimit të Peticioneve të Bundestagut është qendra e marrjes së ankesave të qytetarëve. Ajo trajton kërkesat dhe ankesat drejtuar Bundestagut. Kryetari

⁸ Parlement danois, Reglement, art. 8

i trasmeton peticionet në komisionin e shqyrtimit, i cili u kërkon komisioneve të specializuara të bëjnë observimet për çështjet e ngritura në to. Bundenstagu informohet çdo muaj me listën e peticioneve të trajtuara nga komisioni dhe me rekomandimet që lidhen me to. Një listë e peticioneve të trajtuara nga komisioni dhe rekomandimet përkatëse i jepet çdo muaj Bundestagut. Shpesh komisionet e shqyrtimit të peticioneve konsultohen me gojë ose me shkrim me Avokatin e Popullit.

e) Raportet e kontrollit të komisioneve

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, komisioni harton një raport që përfshin studimin ose hetimin e bërë prej tij, si dhe shpreh konkluzionet e tij. Këto quhen raporte kontrolli ose studimi. Në përgjithësi, për të miratuar një raport të komisionit, është e nevojshme shumica e thjeshtë e anëtarëve. Raporti i përcillet seancës plenare, e cila debaton rreth përmbajtjes dhe konkluzioneve të paraqitura në të. Raporti shërben edhe për aktivitetet e ardhshme të komisionit për këtë çështje ose për çështjet që trajtohen aty. Veç kësaj, raporti mund të konsultohet nga komisionet e tjera parlamentare dhe deputetë që nuk janë anëtarë të këtij komisioni. Raportet e kontrollit të komisioneve mundet gjithashtu t'i jepen qeverisë dhe të bëhen publike për të informuar për punën e komisionit dhe që qeveria të reagojë.

Përmbajtja e një raporti tip të komisionit⁹ përfshin:

- Qëllimin;
- Përmbledhjen e konkluzioneve të komisionit;
- Shqyrtimin e arsyeve përse paraqiten këto konkluzione;
- Konkluzionet;
- Procesverbalin analitik i debatit;
- Dëshmitë e mbledhura dhe komunikimet gojore.

Raporti i komisionit hartohet prej një ose më shumë relatorëve të caktuar nga komisioni. Fillimisht relatorët hartojnë një projektraport që i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga komisioni dhe pastaj raportin përfundimtar të komisionit, i cili i dërgohet seancës plenare.

Komisioni mundet të caktojë disa prej anëtarëve të tij të kontrollojnë ministritë ose fusha të përcaktuara. Për shembull, Komisioni Buxhetor i Bundestagut disponon aq relatorë sa ministri janë. Kur kryesia e komisionit është formalisht e ngarkuar të përgatisë projektraportet, ajo autorizon një grup të posaçëm, të cilit i jep udhëzimet e nevojshme. Këtu mund të përfshihen edhe specialistë të fushës së kompetencës së komisionit. Ekspertët mund të jenë nga stafi, por edhe të jashtëm. Parlamenti mund të autorizojë komisionet e tij të thërrasin këshilltarë të jashtëm për të hartuar raportet. Këshilltarët nuk kanë të njëjtin formim dhe të njëjtin status në të gjithë parlamentet; një parlament mundet të angazhojë njëkohësisht një numër këshilltarësh, sidomos këshilltarë të adresuar prej ministrive e organeve të tjera si dhe ekspertë të angazhuar prej komisioneve (shpesh me kohë të pjesshme).

Meqënëse zakonisht raporti i një komisioni miratohet prej një shumice të thjeshtë, rregullorja parashikon mundësinë që një pakicë e cilësuar të shprehë opinione alternative në raportet e komisioneve. Ekzistojnë dy mundësi: mendimet e tyre të përfshihen në raportin e komisionit, ose grupi që përfaqëson pakicën të paraqesë raportin e tij të ndryshëm nga raporti kryesor

⁹ Les outils du controle parlementaire, Publie par l'UIP, 2007, p. 36

i komisionit. Në disa parlamente bëhen të njohura edhe opinionet alternative të një deputeti të vetëm.

Disa komisione japin opinionin e tyre për çështjet e shqyrtuara nga një komision tjetër. Këto shkëmbime zhvillohen shpesh kur është fjala për buxhetin. Ndërveprimet midis Komisionit të Buxhetit dhe komisioneve të tjera të përhershme mund të ndihmojnë për marrjen e informacioneve dhe të kompetencave në fusha të ndryshme të programeve. Në disa parlamente anëtarët e Komisionit të Buxhetit mund të asistojnë në mbledhjet e komisioneve të tjera të përhershme dhe të marrin kërkesa nga ana e tyre. Në këto vende komisionet e përhershme mund të emërojnë një ose disa anëtarë të tyre që të marrin pjesë si këshilltarë në mbledhjet e Komisionit të Buxhetit.

Marrja në shqyrtim e peticioneve është një tjetër fushë në të cilën raporti i një komisioni lidhet me marrjen e opinionëve të komisioneve të tjera. Në Dhomën e Përfaqësuesve të Belgjikës, komisioni i destinuar për peticionet i dërgon pjesët e përligjuara të raporteve vjetore dhe të raporteve të ndërmjetme të Kolegjit të Mediatorëve në komisionet e përhershme përgjegjëse. Në vazhdim çdo komision i përhershëm i bën raport Dhomës.

Komisionet mund t'u drejtojnë drejtpërsëdrejti ministrive përkatëse raportet e investigimit që përmbajnë rekomandime për organet qeveritare. Nëse qeveria nuk i mban parasysht ato, kjo shënohet në raportin në vazhdim të komisionit. Në Parlamentin polak, rregullorja parashikon që destinatori i një rezolute duhet të mbajë një qëndrim brenda një afati prej 30 ditësh nga marrja e saj, të paktën kur "Marshalli" i Sejmit nuk fikson një afat tjetër. Përgjigjet shqyrtohen gjatë një seance të komisionit. Nëse destinatori nuk përgjigjet në kohën e duhur ose nëse komisioni nuk është i kënaqur prej përgjigjes, ai mundet të rinovojë rezolutën që merr formën e një mocioni mospranimi, që i drejtohet kryetarit të Sejmit për t'u shqyrtuar në seancë plenare.

f) USHTRIMI I FUNKSIONIT TË KONTROLLIT PREJ KOMISIONEVE HETIMORE

E drejta e Parlamentit për të ngritur komisione hetimore është një prerogativë dhe një mjet i domosdoshëm që i nevojitet atij për të ushtruar funksionin e kontrollit, si dhe për të perfeksionuar në tërësi pushtetin e tij legjislativ. Qëllimi i ngritjes së komisioneve hetimore është për të njohur dhe verifikuar në thellësi një fenomen, një ngjarje, një veprimtari, me synimin që në përputhje me realitetin të nxirren përfundime për nevojën e miratimit, plotësimit apo korigjimit të ligjeve të veçanta. Nga ana tjetër, nëpërmjet hetimit parlamentar, kontrollohet edhe zbatimi i ligjeve, nxirret përgjegjësia për mënyrën e qeverisjes dhe bëhen rekomandimet përkatëse me qëllim parandalimin dhe eliminimin e fenomeneve negative, si dhe përmirësimin e gjendjes në të ardhmen.

Së bashku me mjetet e tjera, si pyetjet, interpelancat apo mocionet për debat, ngritja e komisioneve hetimore përbën një instrument të rëndësishëm kontrolli që ushtrohet nga Parlamenti. E drejta e hetimit realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese që parlamentarët kryejnë si përfaqësues të popullit për sqarim apo hulumtim të hollësishëm të çështjes konkrete. Kjo e drejtë shërben njëkohësisht edhe si një mjet në duart e pakicës parlamentare për të ushtruar kontroll kryesisht kundrejt ekzekutivit dhe për të kërkuar vënien përpara përgjegjësisë të

mbajtësve të pushtetit. Meqënëse në një sistem parlamentar qeveria formohet nga shumica parlamentare, e cila ka në dorë shumë mjete të tjera ligjore, e drejta e kontrollit hetimor i shërben sidomos pakicës që, duke i patur të kufizuara mjetet e saj, ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues.

Në disa parlamente hetimet parlamentare mund të kryhen nga njëri prej komisioneve të përhershme. Në këtë rast komisionet e përhershme marrin kompetencat e komisioneve hetimore. Komisioni i përhershëm që dëshiron të bëjë një hetim duhet të marrë autorizim prej parlamentit. Kryetari i komisionit të përhershëm ose të posaçëm, që dëshiron të marrë këto prerogativa, i bën kërkesë kryetarit të parlamentit. Kërkesa menjëherë u bëhet e ditur kryetarëve të grupeve dhe të komisioneve dhe i njoftohet qeverisë. Kërkesa konsiderohet e miratuar nëse kryetari i parlamentit nuk ka pasur kundërshtime nga ana e qeverisë, nga kryetari i një komisioni ose i një grupi parlamentar.

Komisionet e hetimit mund të bëjnë hetime shumë të thelluara për një kohë relativisht të shkurtër dhe të zbulojnë fakte që mund të jenë shqetësuese për qeverinë. Në dallim nga komisionet e përhershme, komisionet e posaçme hetimore krijohen nëpërmjet një vendimi të parlamentit. Misioni i komisionit të posaçëm kufizohet për çështjet e caktuara në rezolutën e parlamentit, në të cilën preçizohet edhe natyra e hetimit. Një komision hetimor mund të jetë më i kufizuar në numër anëtarësh, se komisionet e zakonshme, edhe kur është respektuar parimi i përfaqësimit të barabartë të grupeve parlamentare.

Iniciativa e krijimit të një komisioni hetimor ndryshon nga një parlament në tjetrin. Në shumicën e vendeve, propozimi për ngritjen e një komisioni hetimor të posaçëm mund të bëhet vetëm nga një parlamentar, pa qenë nevoja për bashkëvendësues; megjithatë në shumicën e rasteve duhet një numër minimal deputetësh, që shkon nga 8 në 15 deputetë. Në Spanjë dhe Rumani grupet parlamentare mund të propozojnë ngritjen e komisionit hetimor. Austria dhe Danimarka bëjnë përjashtim: vetëm Komisioni i Punëve të Brendshme i Dhomës, respektivisht Komisioni i Madh dhe Komisioni i Rregullores, kanë mundësi të propozojnë formimin e një komisioni hetimor. Në disa parlamente edhe qeveria mundet gjithashtu të propozojë ngritjen e këtij lloji komisioni. Përgjithësisht mocioni që synon ngritjen e një komisioni hetimor vendoset nga shumica e parlamentit. Në disa vende propozimet fillimisht u dërgohen komisioneve të përhershme sipas fushave që ato mbulojnë. Komisioni shqyrton propozimin dhe i bën raport Dhomës, e cila vendos krijimin e komisionit hetimor duke u mbështetur mbi këtë raport.

Një hetim parlamentar pasqyron rolin kushtetues që luajnë parlamentet në kontrollin e qeverisë. Për rrjedhim, dhomat e larta të parlamenteve të Gjermanisë, të Austrisë, të Polonisë dhe të Republikës Çeke, që nuk luajnë asnjë rol kushtetues në fushën e kontrollit të qeverisë, nuk mund të krijojnë komisione hetimore. Në Slloveni, Dhoma e Lartë nuk mund të krijojë komisione hetimore, por mundet t'i kërkojë Dhomës së Ulët të krijojë një komision të tillë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹⁰ është mjaftuar vetëm me sanksionimin e një dispozite me karakter të përgjithshëm, duke ia lënë ligjit përcaktimin e modaliteteve me dispozita më të hollësishme. Në të përcaktohet :

“2. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 77, pikat 2 dhe 3.

Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore.

3. Komisionet e hetimit vepron sipas procedurës së parashikuar me ligj."

Për shkak të përdorimit në këtë dispozitë kushtetuese të shprehjeve "ka të drejtë" dhe "është i detyruar", Kuvendi vihet në dy pozicione të ndryshme. Në njërin rast, krijimi i komisionit hetimor paraqitet si një e drejtë e Kuvendit, gjë e cila realizohet sipas procedurave të parashikuara në Kushtetutë ose në Rregulloren e Brendshme të Kuvendit dhe që i nënshtrohet vendimmarrjes përkatëse. Nga ana tjetër, dispozita kushtetuese, duke parashikuar shprehjen "*është i detyruar*" merr një tjetër kuptim dhe nuk interpretohet në të njëjtën mënyrë me rastin e mësipërm. Përdorimi në Kushtetutë i shprehjes "*është i detyruar*", jo vetëm që e vendos Kuvendin në një pozicion disi të veçantë, duke i hequr të drejtën për të vlerësuar vendimmarrjen për ngritjen e komisionit hetimor, por njëkohësisht institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare. Në Shtojcat (në fund të librit) paraqitet një listë e të gjitha vendimeve të Kuvendit të Shqipërisë për krijimin e komisioneve hetimore për periudhën 1991-2009.

E drejta për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor është parashikuar në Kushtetutë si e drejtë e një të katërtës së anëtarëve të Kuvendit. Ngritja e komisionit me votën e një pakice, apo siç pranohet në doktrinën kushtetuese, nëpërmjet zbatimit të *parimit të hetimit me votim pakice*, përbën një veçanti të Kushtetutës, e forcon në mënyrë të konsiderueshme rolin e komisionit hetimor si një instrument efikas kontrolli. Në mjaft parlamente europiane, një pakicë e cilësuar (midis 1/5 dhe 1/3 të anëtarëve) mund të kërkojë krijimin e një komisioni hetimor dhe në këtë rast parlamenti bindet për ngritjen e tij. Kushtetuta gjermane përcakton që Bundestagu duhet të krijojë një komision hetimor kur një mocion paraqitet nga 1/4 e anëtarëve. Në Kushtetutën franceze dispozita për krijimin e komisioneve hetimore është futur vetëm në vitin 2008; kushtet dhe procedurat e krijimit të tyre përcaktohen në një ligj të veçantë.

Në Kuvendin e Shqipërisë, në shumicën e rasteve, ngritja e komisioneve hetimore shoqërohet me debate të forta midis shumicës dhe pakicës (opozitës). Arsyeja e debateve gjithmonë ka të bëjë me faktin se shumica nuk pranon objektin e hetimit të përcaktuar nga opozita dhe dëshiron ta ndryshojë atë. Mesa duket përcaktimi se "objekti i hetimit duhet të jetë në përputhje me dispozitat kushtetuese" është shumë i përgjithshëm dhe interpretimi i këtij përcaktimi për "çështje konkrete" të hetimit dominohet nga ngarkesat politike që mbartin palët në debat.

Sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese¹¹, Kushtetuta, duke njohur të drejtën për të ngritur komisione hetimore si e drejtë e një të katërtës së deputetëve për të vepruar në mënyrë të pavarur nga shumica parlamentare, ka evituar njëkohësisht edhe disa pengesa ligjore që mund të krijohen si rrjedhojë e vendimmarrjes. Nëpërmjet shprehjes "*është i detyruar*" ajo ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit, duke vendosur një balancë ndërmjet shumicës dhe të drejtës së pakicës së cilësuar.

Duke mbajtur parasysh interpretimin e Gjykatës Kushtetuese, hapësira e veprimit të kontrollit parlamentar ka dy aspekte: së pari, aspektin e kontrollit të pakufizuar parlamentar dhe, së dyti, aspektin e kontrollit të kufizuar

¹¹ Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, vendimi nr. 18, të datës 18.03.2003

parlamentar. Në aspektin e parë, Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta e pakicës për sa i përket kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor, mbetet një e drejtë e pakufizuar nga vullneti i shumicës. E drejta e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën e shumicës për të ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin e pakicës, me përjashtim të rasteve kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohen se preken parimet kushtetuese. Njëkohësisht, kontrolli parlamentar i Kuvendit është i pakufizuar në ato organe të cilat kanë përgjegjësi politike përpara tij. Në aspektin e dytë, e drejta e një të katërtës së deputetëve për të ushtruar hetimin parlamentar nuk mund të konsiderohet absolutisht e pakufizuar. Kuvendi nuk mund të ngrëjë komision hetimor për çdo çështje dhe për veprimtarinë e çdo organi kushtetues. Objekti i hetimit duhet të jetë në përputhje me respektimin e parimeve të sanksionuara nga Kushtetuta. Ekzistenca e një kufizimi të tillë, edhe pse nuk përmendet në nenin 77 të Kushtetutës, është e kuptueshme dhe buron nga dispozita të tjera të saj. Nga ky vështrim doktrinar që jep jurisprudenca kushtetuese europiane, Gjykata Kushtetuese në interpretimin e saj thekson se *"kontrolli parlamentar duhet zhvilluar në mënyrë të atillë, që të mos ndërhyjë pa kufizim në veprimtarinë e pushteteve të tjera. Një hetim i iniciuar, që nuk lidhet me qëllimet dhe që nuk i përket veprimtarisë së legjislativit, nuk konsiderohet në përputhje me parimet kushtetuese. Ky instrument i rëndësishëm nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njej Kuvendit"*. Prandaj, ushtrimi i këtij mjeti juridik kushtetues për ato çështje dhe në ato pushtete, për të cilat parlamenti mund ta ketë të pamundur ushtrimin e kontrollit, do të dëmtonte këtë kompetencë kushtetuese. Ky interpretim do të ishte i vlefshëm edhe në rastin e debatit të fundit në Kuvendin e Shqipërisë për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për hetimin e zgjedhjeve të 28 qershorit 2009. Objekti i punës së këtij komisioni mund të përfshijë hetimin e procedurave të zbatuara gjatë këtyre zgjedhjeve, por nuk mund të konsiderojë rezultatin zgjedhor të certifikuar nga organet përkatëse kushtetuese.

Në po atë vendim të Gjykatës Kushtetuese thuhet se për gjykatën dhe prokurorinë kontrolli parlamentar është i kufizuar. Këto organe të pavarura nuk mund t'i shkarkojë Kuvendi dhe vetëm Kuvendi. Gjithashtu, Presidentin e Republikës, gjyqtarët kushtetues apo gjyqtarët e Gjykatës së Lartë i shkarkon përfundimisht vetëm Gjykata Kushtetuese, ndërsa Prokurorin e Përgjithshëm e shkarkon përfundimisht Presidenti. Qeveria dhe ekzekutivi në përgjithësi kontrollohen dhe shkarkohen nga Parlamenti. Kontrolli parlamentar mbi organet e pavarura, të cilat nuk janë në përgjegjësinë e tij politike, shtrihet në vlerësimin nëse ato kanë shkelur Kushtetutën dhe ligjet, apo kanë diskredituar rëndë pozitën e tyre dhe nuk përfshin një vlerësim të vendimmarrjes së tyre, sepse këtë funksion Kushtetuta ia ka ngarkuar vetëm gjykatës.

Cilado qoftë procedura e krijimit, të gjitha komisionet e hetimit ndajnë disa karakteristika të përbashkëta:

- Ato disponojnë prerogativa të fushës së investigimit.
- Ato mund t'i përdorin këto prerogativa veçse për çështjet që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me hetimin e që mund të jenë shumë të ngushta.
- Ato mund të krijohen gjatë një mandati legjislativ ose një sesioni parlamentar.
- Ato krijohen nga parlamenti.
- Komisioni i hetimit merr fund kur, në përfundim të afatit të caktuar, depoziton një raport përfundimtar në parlament.

Në Kuvendin e Shqipërisë komisionet hetimore ngrihen dhe veprojnë sipas procedurës së përcaktuar në ligjin¹² "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit".

Komisioni hetimor krijohet me kërkesë të 35 deputetëve. Nismëtarët e ngritjes së komisionit duhet t'i paraqesin kërkesë me shkrim Kryetarit të Kuvendit. Grupi nismëtar paraqet qëllimin e krijimit të komisionit, çështjen që do të hetohet, propozimin për përbërjen e komisionit dhe afatin e përafërt të përfundimit të hetimeve. Kuvendi është i detyruar ta miratojë ngritjen e komisionit. Kuvendi ka të drejtë të krijojë komision hetimi, kur kërkohet nga jo më pak se 5 deputetë ose nga një komision i përhershëm, për hetimin e një çështjeje të veçantë ose kur fillon procedura e shkarkimit të zyrtarëve me imunitet.

Komisioni përbëhet nga jo më pak se 9 dhe jo më shumë se 15 deputetë, por gjithmonë me numër tek. Komisioni përbëhet nga deputetë të partive të pozitës dhe të opozitës, në raporte sa më të afërta përfaqësimi, por diferenca të jetë jo më shumë se një anëtar. Kryetari i komisionit i takon atij grupimi politik, deputetët e të cilit janë nismëtarë të krijimit të komisionit. Në këtë rast zëvendëskryetari i takon grupimit tjetër. Emrat e deputetëve anëtarë të komisionit, raportet e përfaqësimit në komision, si dhe përkatësia politike e vendit të kryetarit dhe zëvendëskryetarit diskutohen në Konferencën e Kryetarëve, të cilat i propozohen Kuvendit për miratim. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të tërhiqen nga komisioni në çdo kohë që ata e çmojnë të arsyeshme, me përjashtim të momentit kur komisioni do të marrë vendimin përfundimtar. Anëtarët e larguar zëvendësohen nga grupimi politik që ata përfaqësojnë, jo më vonë se 3 ditë nga data e deklaramit të tërheqjes së tyre. Anëtari i ri miratohet në seancën plenare më të parë të Kuvendit, me propozim të grupimit politik përkatës. Kur një grupim politik tërheq anëtarët e tij nga komisioni, atëherë Kuvendi i zëvendëson ata me deputetë të tjerë. Në rast se anëtarët e tërhequr të komisionit i takojnë grupimit politik ku bëjnë pjesë nismëtarët e komisionit, Kuvendi vendos pushimin e veprimtarisë së mëtejshme të komisionit.

Komisionet hetimore janë përgjithësisht të pajisuara me më shumë kompetenca se komisionet e përhershme. Dispozitat në lidhje me komisionet hetimore gjenden shpesh në aneksin e rregullores ose në një dokument juridik të veçantë. Komisionet hetimore mund të mbledhin dëshmi. Atyre u jepen edhe prerogativa të tjera. Për shembull, në Bundestagun gjerman rregullat e procedurës penale zbatohen *mutatis mutandis* për mbledhjen e dëshmive. Konfidencialiteti i korrespondencës, i postave dhe i telekomunikacioneve zbatohet me rigorozitet. U kërkohet gjykatave dhe autoriteteve administrative të japin ndihmë juridike dhe administrative. Vendimet e komisioneve të hetimit nuk bëhen objekt i shqyrtimit gjyqësor. Gjykatat janë të lira të vlerësojnë dhe të vendosin mbi faktet e bëra objekt të hetimit.

Një tjetër formë e ushtrimit të funksionit të kontrollit janë edhe *misionet*. Parlamenti mund të vendosë lloje të ndryshme misionesh për të mbledhur informacione. Hetimet parlamentare mund të bëhen tërthorazi nëpërmjet "misioneve të informimit". Misionet e këtij lloji mund të krijohen në gjirin e një komisioni të përheshëm ose të vendosen drejtpërsëdrejti në seancë plenare. Si në njërin rast ashtu edhe në tjetrin, misionet duhet t'u shërbejnë nevojave të parlamentit në tërësi. Misionet e informimit të parlamentit mund të dërgohen jashtë vendit. Midis këtyre misioneve përfshihen delegacionet e mbledhjeve ndërkombëtare dhe instancave ndërparlamentare.

¹² Ligji nr. 8891, datë 2.5.2002

Në rastin kur misionet e informacionit vendosen në komisionet e përhershme, procedura që synon krijimin e këtyre misionëve është e ngjashme me atë që përdorin komisionet për një hetim parlamentar. Komisioni merr një autorizim prej parlamentit dhe kryetari precizon objektin e shqyrtimit. Pasi të jetë marrë autorizimi, komisioni përcakton një ose disa anëtarë të tij për të bërë hetimin. Objektivi i këtij lloji misioni është të marrë informacione të domosdoshme për t'i lejuar parlamentit të ushtrojë funksionin e tij të kontrollit. Këto komisione mund të bëhen pjesë e më shumë se një komisioni njëherësh. Por misionet e informimit mund të vendosen edhe prej vet parlamentit në seancë plenare. Në dallim prej misionëve të vendosura në brendësi të komisionëve të përhershme, misionet e informacionit të vendosura prej parlamentit mund të krijohen direkt prej saj. Në Asambleenë Nacionale franceze, kryetari i Dhomës merr iniciativën e krijimit të një misioni të informacionit. Një formë e misionëve mund të jenë edhe delegacionet parlamentare në mbledhjet ndërqeveritare. Misionet e informimit të krijuara nga parlamenti mundet, nëse kërkohet, të bëjnë kërkime dhe hetime jashtë vendit. Misionet mund të përfshijnë delegacionet parlamentare të dërguara në mbledhjet ndërqeveritare dhe ndërparlamentare.